



Nr. 9 prot
Dt 11/04/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 7, datë 06.04.2023



PËR

SHTYERJEN PËR MBLEDHJEN E ARDHSHME, PEZULLIMIN E LEJES ME NR. SERIE 000154 MIRATUAR NGA KBU DRIN-BUNË ME VENDIMIN NR.6, DATË 20.05.2022 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË (NË RASTIN E UJËRAVE TË RJEDHSHËM) NË RASTIN KUR PËRDORIMI ËSHTË PËR >5 TON/VIT, >5 L/SEK”, SUBJEKTIT “KILIC AQUACULTURE ALBANIA” SH.A

Bazuar në shkronjën “ç”, të pikës 2, të nenit 54, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, dhe në pikën 23, të kreut V, të vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhetë afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë

V E N D O S I:

1. Shtyerjen për mbledhjen e ardhshme, pezullimin e lejes me nr. serie 000154 miratuar nga KBU Drin-Bunë me vendimin nr.6, datë 20.05.2022 “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rjedhshëm) në rastin kur përdorimi është për >5 ton/vit, >5 l/sek”, subjektit “Kilic Aquaculture Albania” sh.a, me vendndodhje Bashkia Vau-Dejës, Qarku Shkodër, deri në njoftimin nga ana e subjektit për vendosjen e matësit.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

